

Këshilli i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 22 dhe neni 20, paragrafi 1, nënparagrafi 10¹ të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 42/20, 77/21, 154/23, 55/24, 193/24 dhe 247/25), në lidhje me nenin 6, paragrafi (1), nënparagrafi 3 dhe nenin 70, paragrafi (7) dhe paragrafi (8) nga Ligji i njëjtë, nenin 15, paragrafi (1), nënparagrafi 23 dhe neni 41, paragrafi (1), nënparagrafi 8 të Rregullores së Punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, nr.ark. 01-3632/1 të datës 22.08.2025 dhe Studimin e Agjencisë, nr.ark. 08-2339/1 të datës 3.6.2026, duke vepruar sipas Kërkesës me shkrim nga palë e interesuar, Shoqëria Tregtare Radiodifuzive 24 VESTI ShPKNJ P Shtip, nr. ark. 03-67/1 të datës 5.2.2020 (PA1 nr.ynë 08-55 të datës 11.2.2020) me plotësimin nr. ark. 03-958/2 të datës 21.9.2020. (PA1 nr ynë. 08-94 të datës 22.9.2020) dhe Aktvendimin e Gjykatës së Lartë Administrative të RMV-së, UZh-2.nr. 89/2024 të datës 6.2.2026 (PA1 nr ynë. 08-55 të datës 3.3.2026), në përputhje me Konkluzionin e Këshillit të Agjencisë, nr.ark.02-2386/4 të datës 10.6.2026, në seancën e 22-të të mbajtur më 10.6.2026, miratoi:

VENDIM

për refuzimin e kërkesës për shpalljen e konkursi publik për dhënien e lejes për transmetim televiziv në nivel shtetëror nëpërmjet multipleksit digjital tokësor

1. REFUZOHET kërkesa me shkrim nga pala e interesuar, Shoqëria Tregtare Radiodifuzive 24 VESTI ShPKNJ P Shtip, me nr.ark. 03-67/1 të datës 5.2.2020 (PA1 nr ynë. 08-55 të datës 11.2.2020) me plotësime nr.ark 03-958/2 të datës 21.9.2020 (PA1 nr. ynë 08-94 të datës 22.9.2020), për shpalljen e konkursi publik për dhënien e lejes për transmetim televiziv të shërbimi programor me format të përgjithshëm kryesisht informues ose format të përgjithshëm me të tre funksionet mediatike (informativ, edukativ dhe rgëtues), në nivel shtetëror, përmes multipleksi digjital tokësor, për shkak se në Studimin për përcaktimin e arsyeshmërisë për shpalljen e konkursi publik për dhënien e lejes për transmetim televiziv në nivel shtetëror përmes multipleksi digjital tokësor (nr.ark.08 - 2339 / 1 të datës 3.6.2026), është përcaktuar se nuk ekziston arsyeshmëri për shpalljen e konkursi publik për dhënien e një leje të re për shërbim televiziv programor me format të përgjithshëm në nivel shtetëror nëpërmjet multipleksi digjital tokësor.

2. Ky Vendim publikohet në faqen e internetit të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

3. Ky Vendim është përfundimtar.

Arsyetim

Këshilli i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në seancën e parë të mbajtur më 9.1.2023, miratoi Vendimin PA1 nr. 08-55 të datës 10.1.2023 për refuzimin e kërkesës me shkrim nga pala e interesuar - Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (ShTR) 24 VESTI ShPKNJ P Shtip nr.ark. 03-67/1 të datës 5.2.2020 (PA1 nr.ynë 08-55 të datës 11.2.2020) me plotësimet nr.ark. 03-958/2 të datës 21.9.2020 (PA1 nr.ark. 08-94 të datës 22.9.2020), për

¹ Paragrafët 8 dhe 9 fshihen, shih: nenin 8 të Ligjit për ndryshim dhe plotësim të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.248/18).

shpalljen e konkursi publik për dhënien e lejes për transmetim televiziv të shërbimi programor me format të përgjithshëm kryesisht informativ ose format të përgjithshëm me tre funksione mediatike (informativ, edukativ dhe argëtues), në nivel shtetëror, përmes multipleksi digjital tokësor. Sa më sipër, për shkak se me Studimin për përcaktimin e arsyeshmërisë për shpalljen e konkursi publik për dhënien e lejes për transmetim televiziv në nivel shtetëror përmes multipleksi digjital tokësor (nr.ark.03-4391/4 të datës 11.12.2020), u përcaktua se nuk ekziston arsyeshmëri për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes për shërbim programor televiziv me format të përgjithshëm kryesisht informativ dhe format të përgjithshëm në të cilin llojet e programeve të përfaqësuara përbushin tre funksione mediatike (informativ, edukativ dhe argëtues), në nivel shtetëror, përmes multipleksi digjital tokësor.

I pakënaqur nga vendimi i miratuar i Agjencisë, ShTR 24 VESTI ShPKNJ P Shtip drejtuar Gjykatës Administrative të RMV-së ka paraqitur Padi, U-Z nr. 57/2023, e pranuar në gjykatë më 13.2.2023, e dorëzuar nga Agjencia më 22.2.2023 (PA1 nr ynë. 08-55), me Ftesë për përgjigje të padisë, U-3 nr.57/2023 të datës 16.2.2023, për të cilin Agjencia më 3.3.2023 ka dhënë përgjigje ndaj padisë PA1 nr.08-55 të datës 3.3.2023 ShTR 24 VESTI ShPKNJ P Shtip, me rastin e përgjigjes së padisë në Agjencinë drejtuar Gjykatës Administrative të RMV-së më 13.6.2023 ka paraqitur përgjigje të padisë (PA1 nr ynë.08-55 të datës 24.1.2024)

Gjykata Administrative e RMV-së me rastin e Padisë së paditësit - ShTR 24 VESTI ShPKNJ P Shtip, miratoi Aktgjykimin U-Z.nr.57/2023 të datës 6.2.2024 (PA1 nr ynë.0801-55 të datës 21.2.2024), me të cilin Padija e paditësit e paraqitur kundër Vendimit PA1 nr.08-55 të datës 10.1.2023, refuzohet si e pabazë.

Kundër Aktgjykimit të cituar të Gjykatës Administrative të RMV-së, paditësi - ShTR 24 VESTI ShPKNJ P Shtip, më 1.3.2024, përmes Gjykatës Administrative të RMV-së drejtuar Gjykatës së Lartë Administrative të RMV-së ka paraqitur Ankesë (PA1 nr ynë. 0801-55 të datës 11.3.2024), ndaj së cilës Agjencia më 15.3.2024, ka paraqitur Përgjigje ndaj ankesës (PA1 nr ynë.0801-55 të datës 15.3.2024).

Më 6.2.2026, nga ana e Gjykatës së Lartë Administrative e RMV-së drejtuar Agjencisë u dorëzua Aktvendim UZH-2.nr.89/2024 të datës 6.2.2026 (PA1 ynë nr. 08-55 të datës 3.3.2026) me të cilën ankesa e paditësit - ShTR 24 VESTI ShPKNJ P Shtip pranohet, Aktvendimi i Gjykatës Administrative U-Z.nr.57/2023 i datës 6.2.2024, ndryshohet dhe është vendosur: Padija e paditësit - ShTR 24 VESTI ShPKNJ P Shtip pranohet, dhe Vendimi i Agjencisë PA1 nr. 08-55 i datës 10.1.2023, anulohet. Gjykata e Lartë Administrative, në Aktgjykimin e cituar, ka sugjeruar se neni 70, paragrafi (4) i LShMAAV-së parashikonte se Agjencia duhej ta përgatisë vetë Studimin.

Duke vepruar sipas Aktgjykimit të Gjykatës së Lartë Administrative të RMV-së, UZH-2.nr.89/2024 të datës 6.2.2026 (ynë PA1 nr.08-55 i datës 3.3.2026), Agjencia ka përgatitur Studim për përcaktimin e arsyeshmërisë për shpalljen e konkursi publik për dhënien e lejes për transmetim televiziv në nivel shtetëror përmes multipleksi digjital tokësor (nr ark.08-2339/1 i datës 3.6.2026). Studimi u publikua në faqen e internetit të Agjencisë më 3.6.2026.²

Studimi përmban gjetjet kryesore, një hyrje dhe pjesët e mëposhtme: 1. Analiza e ofertës ekzistuese mediatike, 2. Analiza e qëndrimeve dhe nevojave të publikut, 3. Analiza e potencialit ekonomik të tregut dhe Konkluzionet.

Gjetjet kryesore të Studimit tregojnë se nuk ekziston arsyeshmëri për shpalljen e konkursi publik për dhënien e leje të re për shërbim programor me format të përgjithshëm në nivel shtetëror; pesë televizione me format të përgjithshëm tashmë funksionojnë në treg dhe nuk ka asnjë televizion të specializuar, gjë që ndjeshëm kufizon diversitetin tematik të ofertës programore; kapacitetet e multipleksit digjital tokësor përfaqësojnë burim të kufizuar dhe për këtë arsye ndarja e tyre duhet të synojë sigurimin e një diversiteti më të madh të ofertës programore (diversiteti i formateve të shërbimeve programore, përmbajtjeve dhe zhanreve programore), dhe jo dyfishimin e koncepteve ekzistuese programore; dhënia e një leje tjetër televizive me format të përgjithshëm nuk do të kontribuonte në përmirësimin thelbësor të pluralizmit mediatik, por do të thoshte përdorim joefikas të burimi të kufizuar publik pa pasuruar ndjeshëm ofertën programore për publikun (audiencën); analiza tregoi mungesë të

shumëllojshmërisë së ofertës televizive, duke pasur parasysh se të pesë televizionet tokësore transmetojnë shërbime me format të përgjithshëm; publiku është vetëm pjesërisht i kënaqur me ofertën ekzistuese programore dhe shikuesit shprehën se mungojnë seriale vendase cilësore, dokumentarë, përmbajtje edukative, sportive dhe për fëmijë, si dhe emisione analitike dhe investigative; analiza ekonomike tregon se tregu televiziv ka kapacitet të kufizuar, dhe stonim si në të ardhurat totale ashtu edhe në të ardhurat nga reklamat.

Pjesa hyrëse e Studimit shpjegon qëllimin e tij, përkatësisht përcaktimin e arsyeshmërisë për dhënien e lejes për transmetim televiziv në nivel shtetëror përmes multipleksi digjital tokësor. Më saktësisht, qëllimi i Studimit është të përcaktojë nëse dhënia e mundshme e një leje të re për transmetim televiziv në nivel shtetëror do të kontribuojë në 1. realizimin më efikas të qëllimit të LShMAAV-së dhe 2. shkallë më të lartë të përmbushjes së nevojave të publikut me përmbajtje programore. Për t'iu përgjigjur qëllimit për të cilin është përgatitur, Studimi metodologjikisht është strukturuar në tre njësi analitike plotësuese: pjesa e parë - analiza e ofertës programore - i referohet formateve të shërbimeve programore të transmetuara nga televizionet tokësore në nivel shtetëror dhe llojeve të ndryshme të përmbajtjeve programore që ato i ofrojnë publikut; pjesa e dytë e Studimit analizon qëndrimet dhe nevojat e publikut në lidhje me ofertën programore të televizioneve vendase dhe pjesa e tretë përmban një analizë ekonomike të industrisë televizive dhe tregut përkatës.

1. "Analiza e Ofertës Ekzistuese Mediatike" tregoi se një numër më i madh mediash automatikisht nuk ofrojnë shumëllojshmëri, prandaj kjo nuk matet vetëm nga numri i mediave, por edhe sipas shumëllojshmërisë së formateve dhe përmbajtjes programore në dispozicion të qytetarëve. Analiza e formateve të shërbimeve programore të pesë televizioneve tokësore tregon mungesë të shumëllojshmërisë në nivelin e parë, duke qenë se të pesë televizionet transmetojnë shërbime programore me format të përgjithshëm. Në nivel shtetëror, nuk ka asnjë stacion televiziv që transmeton shërbim programor të formati të specializuar, gjë që ndjeshëm kufizon shumëllojshmërinë e tematikës së ofertës programore. Plotësuese, të pesë stacionet televizive transmetojnë shërbime programore me format të përgjithshëm me funksion kryesisht argëtues, përkatësisht pjesa më e madhe e përmbajtjeve programore që transmetojnë përmbushin funksionin mediatik argëtues. Prandaj, një rritje e mëtejshme e numrit të televizioneve me format të përgjithshëm nuk do të kontribuojë në rritjen e pluralizmit mediatik dhe shumëllojshmërisë programore. Kapacitetet e lira të multipleksit digjital tokësor duhet të përdoren për të futur kanale të reja televizive të specializuara (për fëmijë, dokumentarë, sportive) që do të pasurojnë dhe thellojnë diversitetin tematik të ofertës totale të programeve televizive. Dhe në nivelin e dytë – shumëllojshmërinë e zhanreve dhe përmbajtjes programore, analiza tregon shumëllojshmëri të kufizuar. Oferta programore e të pesë televizioneve tokësore në nivel shtetëror dominohet nga programet artistike (shumica e të cilave janë seriale artistike të prodhimit turk, gjë që tregon më tej shumëllojshmërinë e kufizuar të zhanreve në ofertën programore).

2. "Analiza e qëndrimeve dhe nevojave të publikut" tregoi se televizioni edhe më tej është mediumi më i përdorur nga qytetarët, gjë që thekson nevojën për të ofruar program të larmishëm dhe cilësor. Oferta ekzistuese televizive nuk arrin në tërësi t'i plotësojë nevojat e publikut. Televizionet vendase arrijnë ta mbajnë publikun me programe informative (lajme dhe emisione debati) dhe seriale televizive, por kanë kapacitet të kufizuar për të plotësuar nevojat e publikut me programe cilësore artistike, sportive, dokumentare, edukative, si dhe programe për fëmijë dhe të rinj. Prandaj, publiku këto përmbajtje i shikon në televizione të huaja që ritransmetohen nga operatorët e rrjeteve publike të komunikimit elektronik. Prandaj, është e qartë se dhënia e një leje tjetër për transmetim televiziv të shërbimi programor me format të përgjithshëm nuk do të kontribuojë në avancimin e pluralizmit mediatik dhe shumëllojshmërisë së përmbajtjeve, as në sigurimin e shumëllojshmërisë më të madhe tematike të ofertës programore.

3. "Analiza Ekonomike" tregon se tregu televiziv i maqedonisë është i vogël dhe i kufizuar. Kjo shihet më së miri përmes të ardhurave totale të të gjitha televizioneve komerciale, të cilat në vitin 2025 arritën në shumë prej 1.4 miliardë denarë, përkatësisht rreth 23 milionë euro. Duke pasur parasysh se kjo shumë u arrit bashkërisht nga të gjitha televizionet në nivel shtetëror, rajonal dhe lokal, është e qartë se bëhet fjalë për një treg me potencial të kufizuar ekonomik. Analiza jo vetëm në shuma reale por edhe në shuma nominale, tregon se tregu i

reklamave nuk po shënon rritje të qëndrueshme dhe të vazhdueshme dhe se ka kapacitet të kufizuar financiar dhe kapacitet të kufizuar për rritje të mëtejshme. Për pjesën më të madhe të periudhës së analizës, televizionet komerciale punuan me fitim të ulët ose me humbje. Analiza e punës ekonomike në pesë televizionet që transmetojnë programe në nivel shtetëror përmes transmetuesi tokësor (Alfa, Alsat-M, Kanal 5, Sitel dhe Telma) tregon se edhe ky segment i tregut televiziv, i cili mbetet segmenti më i rëndësishëm dhe ekonomikisht më i fortë, përballet me sfida serioze dhe punon në kushte të paqëndrueshme dhe paparashikueshme. Të dhënat mbi të ardhurat totale që këto pesë stacione televizive kanë realizuar në secilin prej pesë viteve të fundit tregojnë se tregu po stonon dhe se nuk ka rritje që do të siguronte stabilitet të qëndrueshëm ekonomik. Asnjë nga pesë stacionet televizive nuk ka arritur të ruajë rritje të vazhdueshme të të ardhurave në pesë vitet e fundit. Është veçanërisht domethënëse që në vitin e kaluar katër nga pesë stacionet televizive realizuan më pak të ardhura sesa në vitin e kaluar, gjë që tregon se tregu nuk ka kapacitet për të siguruar qëndrueshmëri as për subjektet ekzistuese.

Pjesa e fundit e Studimit - "Konkluzionet" bashkon gjetjet nga të tre aspektet e analizës dhe bazuar në to është përcaktuar se Analiza e ofertës programore e televizioneve tokësore në nivel shtetëror tregon mungesë të shumëllojshmërisë si në formatet e shërbimeve programore ashtu edhe në përmbajtjen programore që ato transmetojnë. Të pesë televizionet transmetojnë shërbime të formati të përgjithshëm, dhe në nivel shtetëror nuk ka asnjë shërbim televiziv të specializuar.

Gjetjet e këtij studimi tregojnë se nuk ka asnjë arsyeshmëri për shpalljen e konkursit publik për dhënien e një leje të re për shërbim televiziv me format të përgjithshëm në nivel shtetëror.

Për shkak të sa më sipër, duke marrë parasysh detyrimin e Agjencisë sipas nenit 6, paragrafi (1), nënparagrafi 3 të LShMAAV-së për tu kujdesur për mbrojtjen dhe zhvillimin e pluralizmit të shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuale dhe për të nxitur shërbime mediatike të shumëllojshme, të pavarura dhe Studimi në të cilin është përcaktuar mungesa e arsyeshmërisë për dhënien e një leje të re për shërbim programor televiziv me format të përgjithshëm në nivel shtetëror përmes multipleksi digjital tokësor, Agjencia nuk ka bazë ligjore për të ofruar shpalljen e konkursit publik sipas kërkesës së paraqitur. Përkundrazi, në pajtim me nenin 70, paragrafi (7) i LShMAAV-së, në rast se Studimi përcakton se nuk ekziston arsyeshmëri për shpalljen e konkursi publik, Agjencia është e detyruar të marrë vendim me të cilën refuzon kërkesën e paraqitur.

Në pajtim me nenin 70, paragrafi (7) i LShMAAV-së, nëse studimi i përmendur në paragrafin 4, të nenit 70 nga Ligji i njëjtë përcakton se nuk ka arsyeshmëri për shpalljen e konkursit publik, Agjencia, në afat prej 8 (tetë) ditësh nga dita e publikimit të studimit, merr vendim me të cilin refuzon kërkesën e përmendur në paragrafin (1) të nenit 70 nga Ligji i njëjtë.

Në lidhje me të gjitha sa më sipër, në pajtim me nenin 70, paragrafi (7) i LShMAAV-së, duke marrë parasysh se me Studimin e Agjencisë për përcaktimin e arsyeshmërisë për shpalljen e konkursit publik (nr.ark.08-2339/1 të datës 3.6.2026), është përcaktuar se nuk ekziston arsyeshmëri për shpalljen e konkursit publik për dhënien e një leje të re për shërbim programi televiziv me format të përgjithshëm në nivel shtetëror përmes multipleksi digjital tokësor, Këshilli i Agjencisë, në seancën e 22-të të mbajtur më 10.6.2026, shqyrtoi dhe miratoi Propozimin PA1 nr. 08-148 të datës 8.6.2026, të paraqitur nga dr. Zoran Trajčevski, drejtor i Agjencisë, për miratimin e vendimit me të cilin do të refuzohet Kërkesa me shkrim nga pala e interesuar, Shoqëria Tregtare Radiodifuzive 24 VESTI ShPKNJ P Shtip, nr.ark 03-67/1 të datës 5.2.2020 (PA1 nr ynë. 08-55 të datës 11.2.2020) me plotësim nr ark. 03-958/2 të datës 21.9.2020 (PA1 nr ynë. 08-94 të datës 22.9.2020).

Rrjedhimisht nga sa më sipër, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 22 dhe neni 20, paragrafi (1), nënparagrafi 10³ të LShMAAV-së, në lidhje me nenin 6, paragrafi (1), nënparagrafi 3, nenin 70, paragrafi (7) dhe paragrafin (8) nga Ligji i njëjtë, nenin 15, paragrafi (1), nënparagrafi 23 dhe neni 41, paragrafi (1), nënparagrafi 8 të Rregullores së Punës së Agjencisë dhe Studimit

³ Paragrafët 8 dhe 9 fshihen, shih: nenin 8 të Ligjit për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 248/18).

e Agjencisë, nr. ark. 08-2339/1 të datës 3.6.2026, duke vepruar sipas Kërkesës me shkrim nga pala e interesuar, ShTR 24 VESTI ShPKNJ P Shtip, nr. ark. 03-67/1 i datës 5.2.2020. (PA1 nr ynë.08-55 i datës 11.2.2020) me plotësimin nr. ark. 03-958/2 të datës 21.9.2020 (PA1 nr. ynë 08-94 i datës 22.9.2020) dhe Aktvendimin e Gjykatës së Lartë Administrative të RMV-së, UZH-2. nr.89/2024 të datës 6.2.2026 (PA1 nr. ynë 08-55 i datës 3.3.2026), dhe në pajtim me Konkluzionin e Këshillit të Agjencisë, ark. nr.02-2386/4 i datës 10.6.2026 , në seancën e 22-të të mbajtur më 10.6.2026 u miratua Vendim për refuzimin e Kërkesës me shkrim nga pala e interesuar ShTR 24 VESTI ShPKNJ P Shtip për shpalljen e konkursi publik për dhënien e lejes për transmetim televiziv të shërbimi programor me format të përgjithshëm kryesisht informativ ose format të përgjithshëm me të tre funksionet mediatike (informativ, edukativ dhe argëtues), në nivel shtetëror, përmes multipleksi digjital tokësor, me arsyetimin se Studimi për përcaktimin e arsyeshmërisë për shpalljen e konkursi publik për dhënien e lejes për transmetim televiziv në nivel shtetëror përmes multipleksi digjital tokësor (nr.ark 08-2339/1 të datës 3.6.2026) u përcaktua se nuk ekziston arsyeshmëri për shpalljen e konkursi publik për dhënien e një leje të re për shërbim programi televiziv me format të përgjithshëm në nivel shtetëror nëpërmjet multipleksi digjital tokësor.

Bazuar në sa më sipër, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive ka miratuar vendimin si në dispozitiv. Vendimi është përfundimtar dhe kundër tij mund të ngrihet padi pranë gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit. Vendimi do të publikohet në faqen e internetit të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizive.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizive
Kryetari i Këshillit,
mr. Sasho Stefanovski**

Këshillë juridike: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij mund të ngrihet padi pranë gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të vendimit.

Përktheu: Antoneta Shabani